



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr.115/11 Prot.

Tiranë, më 26.07.2016

V E N D I M

Nr.93, datë.26.07.2016

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit nr.25, datë 18.03.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.115/1, dt.16.02.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.15446/1, dt.20.06.2016, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.25, dt.18.03.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.115/1, dt.16.02.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërejtje se:

Në zbatim të Urdhrit të Verifikimit nr.115/1, dt.16.02.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në ecurinë e marrëdhënies së punësimit, të punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ***** , në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Projekteve TIK”, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është kryer hetimi i plotë administrativ.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.25, datë 18.03.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin nr.115/1 prot., dt.16.02.2015”, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike që për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, të konstatojë si akt absolutisht të pavlefshëm, aktin administrativ nr.1603/1092, datë 08.06.2015, të Departamentit të Administratës Publike, që ka lidhje

me deklarimin e statusit të punësimit, si nëpunës civil në periudhë prove, të punonjësit ***** , pasi ka dalë në shkelje flagrante të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

2. Të konstatoj, si akt absolutisht të pavlefshëm, aktin administrativ nr. 13787 prot, datë 23.04.2015, “Për konfirmimin nëpunës civil pas përfundimit të periudhës së provës”, i nxjerrë nga eprori direkt, pasi ka dalë mbështetur mbi një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm.
3. Departamenti i Administratës Publike, referuar nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, sipas rregullimit të posaçëm ligjor në këto dispozita, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.
4. Njësia përgjegjëse, të marrë masat për të shpallur si të lirë pozicionin e punës, me qëllim që ai të plotësohet në përputhje me kërkesat e nenit 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

Me kalimin e afatit procedural të parashikuar në pikën 5, të Vendimit nr.25, dt.18.03.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.15446/1, dt.21.06.2016, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore ka njoftuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e vendimit të mësipërm.

Nga verifikimi i dokumenteve bashkëngjitur kësaj shkrese, rezultoi se:

- ✓ Në zbatim të pikës 1 të Vendimit nr. 25, datë 18.03.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Departamenti i Administratës Publike me anë të vendimit nr.115, dt.07.04.2016, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit nr.1603/1092, dt.8.6.2015, për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësin ***** me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Projekteve TIK”, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- ✓ Në zbatim të pikave 2 dhe 3 të vendimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në cilësinë e njësisë përgjegjëse me anë të Vendimit nr.401, dt. 20.06.2016, ka vendosur lirimin nga detyra të punonjësit *****.
- ✓ Në lidhje me zbatimin e pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse, bazuar në Vendimin nr.108, datë 26.2.2016 “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil” ka marrë masat për shpalljen të lirë të pozicionit të punës të ankuesit, me qëllim që ai të plotësohet në përputhje me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sa më sipër, konstatoj se, Vendimi nr.25, datë 18.03.2015 , “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.115/1, dt.16.02.2016”, është zbatuar në tërësi, nga ana e subjektit, **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.**

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.25, dt.18.03.2016, në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 25, datë 18.03.2016 ,“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.115/1, dt.16.02.2016”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administrës Publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA